



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada - Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
**Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice**

Nr. 86 /2021  
Datë: 20 . 05 .2021

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar ne nenin 58 (paragrafi 6) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë (Gazeta Zyrtare nr.23/2018, 26.12.2018), si dhe në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullorës (QRK) – Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021) Ministria e Drejtësisë nxjerr:

**V E N D I M**

1.Caktohet Komisioni për pranimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara në Zyrën e Noterit Ilmi (Avdi) Ademi në Komunën e Vushtrrisë dhe dorëzimin e tyre në Gjykatën Themelore në Mitrovicë Dega Vushtri, në këtë përbërje:

- 1.1. Erdon Gjinolli, Sekretar i Odës së Noterëve, Kryesues,
- 1.2. Burbuqe Spahija Kërveshi, Zyrtare e lartë për noterinë dhe përmbarimin privat, anëtare,
- 1.3. Skender Kaçiku, Zyrtar i Arkivës, anëtar.

2.Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi, mban procesverbal për pranim-dorëzimin e dokumenteve, shënimeve, librave, vulave dhe gjësendeve të depozituara.

3.Komisioni fillon punën nga dita e pranimi të këtij vendimi dhe nuk duhet të ketë ndërprerje dhe shkëputje deri në përfundimin e kësaj çështje.

4.Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albulena Haxhiu**

**Ministre e Drejtësisë**



*Vendimi i dërgohet:*

- Anëtarëve të Komisionit,
- Noterit,
- Odës së Noterëve,
- Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega Vushtrri,
- Departamentit për Profesione të Lira,
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.